KONTRATË SHKEMBIM AKSIONESH
TË SHOQËRISË "AL GLOBAL OIL" SH.A. dhe SHOQERISE "EUROPETROL GROUP" SHA.

Sot, në Tiranë, më date 25/11/2020 (dymijë e njezete), ne seline e shoqerise "AL-GLOBAL OIL " SH.A ne prezencen e te gjitha paleve permendur me poshte, te cilet me deshire te lire dhe me vullnet te plote e te pavesuar kerkuan redaktimin e Kontrates se Shkembimit te Aksionesh si me poshte:

Z. Qazim QAZIMI, shtetas shqiptar, i biri i Ademit, lindur me 22/06/1942, ne Peqin,Shqiperi, banues ne Tirane, mbajtës i kartes identitetit Nr.Personal E20622034D, leshuar ne dt.07/09/2009 nga M.B, në cilësinë e shkembyesit te 1,190 aksioneve me te drejte vote qe perfaqsojne 34% te kapitalit aksioner te Shoqerise "AL-GLOBAL OIL " SH.A.;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "***Shkembyesi i Pare***");

dhe

Shoqeria "EUROPETROL GROUP" SHA me Nipt L81925022T dhe adrese: Bulevardi Zhan D'Ark, Pallati 5,1/1,Tirane, perfaqsuar nga Ortaket e saj si me poshte:
Asllan Kuqi, i biri i Skënderit, i datëlindjes 08.01.1963, me numër letërnjoftimi ID 030237157, me banim ne Durres.
Skender Kuqi, i biri i Fridentit, i datëlindjes 06.08.1984, me numër letërnjoftimi ID 032568678, me banim ne Tirane.
Gerian Kuqi, i biri i Fridentit, i datëlindjes 23.08.1986, me numër letërnjoftimi ID 027948957, me banim ne Tirane.
Eno Kuqi, i biri i Fridentit, i datëlindjes 13.10.1996, me numër letërnjoftimi ID 03259668, me banim ne Tirane.
Në cilësinë e shkembyesit te 350 aksioneve me te drejte vote qe perfaqsojne 10 % te kapitalit aksioner te Shoqerise "EUROPETROL GROUP" SH.A

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "***Shkembyesi i Dyte***");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, **Z. Qazim QAZIMI** dhe **Shoqeria "EUROPETROL GROUP" SHA** do të referohen veçmas si Shkembyesi i Pare dhe Shkembyesi i dyte dhe së bashku si Shkembyesit.

BAZA LIGJORE:
Kjo kontrate hartohet ne baze dhe per zbatim te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, nenet 757-760, si dhe bazuar ne deshiren e lire dhe ne vullnetin e plote e te pavesuar te paleve te kesaj kontrate.

MEQENËSE:

a. **Shoqëria "AL-GLOBAL OIL " SH.A**.,është një shoqëri tregtare Aksionere, me dy nivele e themeluar qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqiperisë, e regjistruar me

dt. 14/10/2016 ne Regjistrin Tregtar Shqiptar prane QKB, me NIPT L62214509P, me seli ne Njesia Administrative Nr.5,Rruga "Sulejman Delvina", Ndertesa.11, Hyrja 10, Ap.7,1019, Shqipëri.

Kapitali themeltar aksioner i shoqerise eshte 3,500,000 (tremilion e peseqindmije) Lek (ALL) dhe eshte i ndare ne 3,500 (tremije e peseqind) aksione me vlere nominale aksioni prej 1,000 (njemije) Lek.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin themeltar aksioner te shoqerise eshte, ne baze te kontributeve te bera ne vlere monetare, e ndare si me poshte:

- **Ridgers MEMA**, zoteron 2,310 (dymije e treqind e dhjete) aksione, me vlere nominale aksioni prej 1,000 (Njemije) lek dhe ne vlere absolute ne total prej 2,310,000 (dymilion e treqind e dhjete mije) Lek qe perben 66 % te kapitalit aksioner baze te shoqerise;
- **Qazim QAZIMI**, zoteron 1,190 (njemije e njeqind e nentedhjete) aksione, me vlere nominale aksioni prej 1,000 (Njemije) lek dhe ne vlere absolute ne total prej 1,190,000 (njemilion e njeqind e nentedhjete mije) Lek qe perben 34% te kapitalit aksioner baze te shoqerise;

Sikurse rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar te printuar online nga QKB për të dhënat e Shoqërisë ne daten 19 Nentor 2020, Shkembyesi i Pare zotëron 34 % të kapitalit aksioner të regjistruar të Shoqërisë **(në vijim "Aksionet") si me poshte;**

- **Qazim QAZIMI,** zoteron 1,190 (njemije e njeqind e nentedhjete) aksione, me vlere nominale aksioni prej 1,000 (Njemije) lek dhe ne vlere absolute ne total prej 1,190,000 (njemilion e njeqind e nentedhjete mije) Lek qe perben 34% te kapitalit aksioner baze te shoqerise;

b. **<u>Shoqëria "EUROPETROL GROUP" SH.A</u>**.,është një shoqëri tregtare Aksionere, me dy nivele e themeluar qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqiperisë, e regjistruar me dt. 25/07/2018 ne Regjistrin Tregtar Shqiptar prane QKB, me NIPT L81925022T, me seli ne Njesia Administrative Nr.5,Rruga "Sulejman Delvina", Ndertesa.11, Hyrja 10, Ap.7,1019, Shqipëri.

Kapitali themeltar aksioner i shoqerise eshte 3,500,000 (tremilion e peseqindmije) Lek (ALL) dhe eshte i ndare ne 3,500 (tremije e peseqind) aksione me vlere nominale aksioni prej 1,000 (njemije) Lek.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin themeltar aksioner te shoqerise eshte, ne baze te kontributeve te bera ne vlere monetare, **(në vijim "Aksionet") si me poshte**:

- **Asllan KUQI,** zoteron 1,150 (njemije e njeqind e pesedhjete) aksione, me vlere nominale aksioni prej 1,000 (Njemije) lek dhe ne vlere absolute ne total prej 1,150,000 (njemilion e njeqind e pesedhjete mije) Lek qe perben 30 % te kapitalit aksioner baze te shoqerise;
- **Skender KUQI,** zoteron 840 (teteqind e dyzete) aksione, me vlere nominale aksioni prej 1,000 (Njemije) lek dhe ne vlere absolute ne total prej 840,000 (teteqind e dyzete mije) Lek qe perben 24% te kapitalit aksioner baze te shoqerise;

- **Gerian KUQI,** zoteron 805 (teteqind e pese) aksione, me vlere nominale aksioni prej 1,000 (Njemije) lek dhe ne vlere absolute ne total prej 805,000 (teteqind e pese mije) Lek qe perben 23% te kapitalit aksioner baze te shoqerise;
- **Eno KUQI,** zoteron 805 (teteqind e pese) aksione, me vlere nominale aksioni prej 1,000 (Njemije) lek dhe ne vlere absolute ne total prej 805,000 (teteqind e pese mije) Lek qe perben 23% te kapitalit aksioner baze te shoqerise;

Sikurse rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar te printuar online nga QKB për të dhënat e Shoqërisë ne daten 19 Nentor 2020, Shkembyesit zotërojne 100 % të kapitalit aksioner të regjistruar të Shoqërisë.

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 **OBJEKTI**

1.1. Palet nepermjet kesaj Kontrate Shkembimi Aksionesh bejne kalim reciprok te pronesise nepermjet shkembimit te aksioneve pa kundershperblim midis tyre si me poshte:
Z.Qazim QAZIMI. Shkembyesi i Pare i shkemben aksionet e zoteruara prej tij,ne vlere absolute 1,190,000 (njemilion e njeqind e nentedhjete mije) Lek gjithsej 1,190 (njemije e njeqind e nentedhjete) aksione me vlere nominale prej 1,000 lek. te cilat perfaqsojne 34% të kapitalit aksioner te shoqerise Al.Global Oil Sha të regjistruar prane QKB. dhe fiton pronësinë e aksioneve nga **Shkembyesi i dyte** ne Shoqerise "EUROPETROL GROUP" SHA mbi gjithsej 350 (treqind e pesedhjete) aksione me vlere nominale prej 1,000 lek dhe ne vlere absolute ne total prej 350,000 (treqind e pesedhjete mije) Lek, te cilat perfaqsojne 10% të kapitalit aksioner te regjistruar të Shoqërisë "EUROPETROL GROUP" SHA prane QKB.

1.2. **Shoqerisa "EUROPETROL GROUP" SHA Shkembyesi i dyte** i shkemben aksionet e zoteruara prej saj,ne vlere absolute 350,000 (treqind e pesedhjete mije) Lek gjithsej 350 (treqind e pesedhjete) aksione me vlere nominale prej 1,000 lek. te cilat perfaqsojne 10% të kapitalit aksioner te shoqerise "EUROPETROL GROUP" SHA të regjistruar prane QKB. dhe fiton pronësinë e aksioneve nga **Shkembyesi i pare** ne Shoqerise "AL.GLOBAL OIL" SHA mbi gjithsej 1,190 (njemije e njeqind e nentedhjete) aksione me vlere nominale prej 1,000 lek dhe ne vlere absolute ne total prej 1,190,000 (njemilion e njeqind e nentedhjete mije) Lek, te cilat perfaqsojne 34% të kapitalit aksioner te regjistruar të Shoqërisë "AL.GLOBAL OIL" SHA prane QKB.

Neni 2 **DEKLARIMET DHE GARANCITE**

2.1 **Pala Shkembyesi i Pare** deklaron dhe vertetojne se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron aksionet që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t`i transferuar nepermjet shkembimit këto aksione dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga ai nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave jane Shkembyesit.

2.2 **Pala Shkembyesi i dyte** deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ka tagra të plota për të pranuar shkembimin e aksioneve nga Shkembyesi i pare sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate shkembimi dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shkembyesi i dyte nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është ai.

Neni 3 **TRANSFERIMI I TE DREJTAVE MBI AKSIONET.**

3.1 **Pronësia mbi aksionet e shkembyera te Shoqërisë Al.Global Oil Sha**, Objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shkembyesi i Pare tek Shkembyesi i dyte menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së aksioneve të Shoqërisë AL.GLOBAL OIL SHA në favor të Shkembyesit te dyte do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008, te ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, te ndryshuar.

3.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate,Shkembyesit i dyte "EUROPETROL GROUP" SHA fiton pronësinë mbi Aksionet e shkembyera dhe bëhet aksioner i Shoqërisë "Al.Global Oil" Sha duke zotëruar gjithsej 1,190 (njemije e njeqind e nentedhjete) aksione, që përfaqësojne 34% kapitalin aksioner të Shoqërisë, ndërsa Shkembyesi i pare Z. Qazim Qazimi e humbet te drejten per pjesen e aksioneve te shkembyera.

3.3 **Pronësia mbi aksionet e shkembyera te Shoqërisë "EUROPETROL GROUP" SHA,** Objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shkembyesi i Dyte tek Shkembyesi i pare menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së aksioneve të Shoqërisë "EUROPETROL GROUP" SHA në favor të Shkembyesit te pare Z.Qazim Qazimi do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008, te ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, te ndryshuar.

3.4 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate,Shkembyesi i pare Z.Qazim Qazimi fiton pronësinë mbi Aksionet e shkembyera dhe bëhet aksioner i Shoqërisë "EUROPETROL GROUP" SHA duke zotëruar gjithsej 350 (dyqind e dhjete) aksione, që përfaqësojne 10 % kapitalin aksioner të Shoqërisë, ndërsa aksioneret e Shkembyesit e dyte humbin te drejten per pjesen e aksioneve te shkembyer si me poshte:

- Skender Kuqi, humbet te drejten e pronesise per 140 (njeqind e dyzete) aksione dhe pas shkembimit i mbeten ne pronesi 700 (shtateqind) aksione te cilat perfaqsojne 20% te kapitalit te shoqerise.
- Gerian Kuqi, humbet te drejten e pronesise per 105 (njeqind e pese) aksione dhe pas shkembimit i mbeten ne pronesi 700 (shtateqind) aksione te cilat perfaqsojne 20% te kapitalit te shoqerise.
- Eno Kuqi, humbet te drejten e pronesise per 105 (njeqin e pese) aksione dhe pas shkembimit i mbeten ne pronesi 700 (shtateqind) aksione te cilat perfaqsojne 20% te kapitalit te shoqerise.

3.5 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shkembimi aksionesh, te dy palet si Z.Qazim Qazimi edhe Shoqeria "EUROPETROL GROUP" SHA gëzojne të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi aksionet e zotëruara, referuar kesaj kontrate shkembimi, në emër të tyre në

Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4 TE NDRYSHME

4.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate shkembimi do të jetë e vlefshme pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të cënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

4.2. Kjo Kontratë shkembimi aksionesh do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, te ndryshuar dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.3. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4 (kater) kopje origjinale.

Kjo Kontratë Shkembimi Aksionesh, pasi u lexua nga Palët me zë të lartë e të qartë, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve dhe

me firmosjen e saj merr fuqine ligjore sipas ligjeve te permendura me siper me te gjithë efektet që passjell.

SHKEMBYESI I PARE

Ortaku i "AL.GLOBAL OIL " SH.A.,

(Nenshkrimi/firma)

Qazim QAZIMI _____;

SHKEMBYESI I DYTE

Ortaket e "EUROPETROL GROUP" SHA

(Nenshkrimi/firma)

Asllan KUQI _____

Skender KUQI _____

Gerian KUQI _____

Eno KUQI ENO KUQI